
RREGULLORE NR. 2006/23

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI THEMELIMIN E INSTITUTIT
GJYQËSOR TË KOSOVËS TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin e dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) e datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 7 mars 2006 lidhur me Ligjin mbi themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës të miratuar nga Kuvendi më 23 shkurt 2006,

Duke pasur parasysh përgjegjësitë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes sipas neneve 5.3(e) dhe 5.3(f) të Kornizës Kushtetuese,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin dhe kompetencat e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

A. Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (Ligji nr. 02/L-25), i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje, duke iu nënshtruar pjesës së mëposhtme B dhe

B. Përcakton që në Ligj të bëhen ndryshimet vijuese:

1. Fjalët “pasardhësit ligjorë” në nenet 1.8, 7.3, 8.2, 10.1 dhe 11.3 dhe fjalët “pasardhës ligjor” në nenet 1.9, 3.2, 8.1 dhe 9.1 të ndryshohen në “pasardhës ligjor/pasardhësit ligjorë”.

2. Neni 1.5 ndryshohet si vijon:

Bordi menaxhues e emëron drejtorin e IGJK-së në bashkërendim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm pas shpalljes së konkursit publik.

3. Neni 1.6 ndryshohet si vijon:

Në rastet e arsyetuara, Bordi menaxhues e shkarkon drejtorin e IGJK-së në bashkërendim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Kreu i nenit 3.3 ndryshohet si vijon:

Nëntë anëtarët emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bashkërendim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, me propozimin e institucioneve vijuese:

5. Neni 4.3 ndryshohet si vijon:

Koordinatori i programit emërohet nga komisioni i themeluar nga Bordi menaxhues pas shpalljes publike të konkursit, në pajtim me rregullat dhe procedurat e zbatueshme për shërbimin civil.

6. Neni 5.1(a) ndryshohet si vijon:

Është person i cili është regjistruar ose ka të drejtë të regjistrohet si banor i përhershëm i Kosovës në Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 të datës 17 mars 2000 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil,

7. Neni 7.2 ndryshohet si vijon:

Kandidatët për postin e gjyqtarit apo prokurorit zgjedhen në bazë të konkurrimit publik dhe të hapur përmes të cilit ata i nënshtrohen provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë. Personi mund të zgjedhet si kandidat për postin e gjyqtarit apo prokurorit vetëm nëse e kalon provimin përgatitor për gjyqtar dhe prokuror. Përvoja e punës dhe rezultati i provimit të jurisprudencës gjithashtu mund të merren parasysh në zgjedhjen e kandidatëve për postin e gjyqtarit apo të prokurorit.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 24 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm